



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:076404

Datë: 15.03.2019

Numri i dokumentit: 00247345

P.nr.267/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit Sh.T nga Prizren, me numër personal ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2-1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/IL.nr.393-3/19 , të datës 12.03.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro të pandehurit Sh.T,dhe mbrojtësit të tij avV.K me datë 15.03.2019 mori , këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh.Tnga i ati Y. e ema F.mbiemeri i vajzërisë H., i lindur me ... ne Prizren rr. ... pn, Prizren, ka të kryer shkollën e mesme, fermer , me nr. personal ... shqiptar shtetas i R. Te Kosoves.

ESHTE FAJTOR

Se me datën 18.02.2019 rrrth orës 19,52 min, ne rr.... ne Prizren ne lokalim “...” i shkakto lëndime të lehta trupor të dëmtuarit G.J qe rezulton me pasoja të përkohshme në shëndet në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të mëhershme fillimisht fjalosen e me pas fillojnë të kacafyten në mes vete ku një moment i pandehuri e godet me thike në krahun e majte mjet ky i përshtatshëm dhe i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor duke i shkaktoar lëndime të lehta trupore dhe atë , plage prerëse, shpuese në regjionin e krahut të majte të përshkuara me për se afërmi në akt ekspertimin mjekoligjor .

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2-1 nën par.1.4 të KP-së.

I dëmtuari G.J për rrlazimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur ne mes te prokurorit te shtetit pranë Prokurorisë Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm dhe te akuzuarit Sh.T me mbrojtësin av.V.K PP./II.nr.393/19 e dt. 11.03.2019.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3,4,41,43,45, 46, 47 të KP-se, te pandehurit i shqipton

DËNIM ME BURG

Ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, ne te cilin dënim llogaritet koha e kaluar ne paraburgim prej 18.02.2019 e gjere me dt. 15.03.2019 .

Ne kuptim te nenit 47 te KP te akuzuarit dënimi i ngelur me burg i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate, ne afatin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri qe te i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, , dhe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 50 euro, ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarit I caktohet taksa ne shume prej nga 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP./II.nr.393/19 e dt. 11.03.2019 , ndaj te akuzuarit Sh.T nga Prizreni për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2-1 nen par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Prokuroria Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm përkitazi lidhur me aktakuzën PP./II.nr.393/19 e dt. 11.03.2019 , me te akuzuarin Sh.T me mbrojtësin av. V.K , kane hyre ne marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin e dt.15.03.2019 i mbajtur ne këtë çështje penale përkitazi për marrëveshjen e cekur me lartë gjykata bazuar ne nenin 233 te KPP-së, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e ka dëgjuar te akuzuarin ne prezencën e mbrojtësit te tij , dhe ka konstatuar se pranimi është bere vullnetarisht nga ana e te akuzuarit pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 paragrafi 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u mur ne kuptim te nenit 463 par.2 te KP.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:076404, 15.03.2019

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.